

**Projekti IPA 2008 me temë;
“Ngritje kapacitetesh për implementimin e Strategjisë së Zhvillimit Rural”**,

**Kohëzgjatja 24 muaj,
Shuma e akorduar 2 mln €
Partner: Drejtoria e Politikave Rurale**

Objektivi i Përgjithshëm: Përmirësimi i cilësisë së jetës në zonat rurale nëpërmjet rritjes së konkurrueshmërisë së produkteve bujqësore, agroushqimore si dhe diversifikimit të ekonomisë rurale dhe mbrojtjes së mjedisit.

Qellimi: Ngritja dhe forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative të Ministrisë për të hartuar, zhvilluar dhe zbatuar politikat korrekte në kuadër të parapërgatitjes për aderimin në BE me ndihmën e fondeve para-aderuese IPARD.

Ky projekt përbëhet nga katër komponentë:

I. Komponenti i parë: Përmirësimi dhe konsolidimi i kapaciteteve për analizat e politikave.

- a) Një vlerësim i plotë i mungesave të kapaciteteve për analizën dhe formulimin e politikave të zhvillimit rural në kuadër të asistencës Europiane lidhur me programet para-aderuese;
- b) Krijimi dhe konsolidimi i një zyre të veçantë për analizat e Politikave Rurale;
- c) Përcaktimi i trajnimeve dhe kualifikimi i stafit të ardhshëm të zyrës së analizave të politikave rurale;
- d) Implementimi i Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit Rural (SKZHR) në nivel rajonal në sinergji me Planet Sektoriale dhe investimet;
- e) Konsultimi i planeve të zhvillimit rural rajonal në komunitetin lokal.

II. Komponenti i dytë: Ngritja dhe funksionimi i sistemit të informacionit bujqësor.

- a) Vlerësimi i sistemeve ekzistuese të informacionit bujqësor;
- b) Zhvillimi i koncepteve bazë të sistemit të informacionit bujqësor për të siguruar të dhënat e duhura lidhur me analizat e politikave;
- c) Identifikimi i Agjensisë përgjegjëse për grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave si dhe trajnimi i stafit;
- d) Transferimi dhe shkembimi i të dhënave nga burime të tjera.

III. Komponenti i tretë: Ngritja dhe funksionimi i strukturave të IPARD.

- a) Përcaktimi i nivelit të strukturave të IPARD-it tashmë të ngritur në Ministri, funksionimi dhe detyrat e stafit (Autoriteti Menaxhues dhe Agjensia IPARD);
- b) Rishikimi i kuadrit ligjor dhe institucional;
- c) Përcaktimi i trajnimit të stafit lidhur me funksionet dhe detyrat;

- d) Përpilimi i procedurave financiare dhe ligjore për një implementim, menaxhim dhe kontroll të plotë;
- e) Përcaktimi i procedurave të akreditimit të këtyre strukturave.

IV. Komponenti i katërt; Teknologjia e informacionit;

- a) Shqyrtimi dhe identifikimi i prioriteteve për teknologjine e informacionit lidhur me strukturën operative të informacionit për bujqësinë
- b) Prgatitja e dokumentave për tenderin e paisjeve
- c) Ngritja e rrjeteve te IT